



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHMË E BUXHETIT  
DREJTORIA E FINANCËVE VENDORE

Nr. 11099 Prot

Tiranë, më 19/06/2023

Lënda: Dërgohen mendimet mbi Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026

BASHKISË SHKODER


KËSHILLIT TË QARKUT \_\_\_\_\_

Në zbatim të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe të udhëzimit vjetor të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë me nr.6 datë 28.02.2023, “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026”, bashkëlidhur ju dërgojmë komentet dhe rekomandimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi projekt-dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026.

Gjithashtu, ju bëjmë me dije që procesi dhe procedura e vazhimit të fazës së dytë për miratimin e programit buxhetor afatmesëm dhe buxhetit vjetor do të zbatohet në përputhje të plotë me kërkesat ligjore të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM





---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT  
DREJTORIA E FINANCAVE VENDORE

## **ANALIZA E PBA 2024-2026**

**BASHKIA SHKODËR**

## **I. Vështrim i Përgjithëm**

Bashkia Shkodër në përputhje me strategjitë e miratuara synon zhvillimin në disa drejtime: a) Një bashki me një zhvillim territorial të integruar e cila garanton barazinë në shërbime dhe në akses ndaj qytetarëve dhe vizitorëve bazuar në një sistem policentrik të zhvillimit. b) Një qendër primare me një cilësi të lartë jetese ku ballinat ujore dhe zonat historike gjallërojnë jetën urbane të Bashkisë Shkodër. c) Një Bashki e cila promovon dhe mbështet sipërmarrjet e reja duke tërhequr talentin vendas e rajonal. Bashkia Shkodër mbështet skenarin policentrik të zhvillimit të territorit të saj. Ky skenar paraqitet si koncept në dy nivele, si në nivelin Bashkiak, ku për qëllime të kohezionit territorial kërkohen disa qëndërsi të reja në ofrimin e shërbimeve bazë (shkollë, qendër shëndetësore, postë), ashtu dhe në nivel qyteti, ku shërbimet dhe aktivitetet duhet të shpërndahen më shumë në territor. Disa nga sfidat e zhvillimi të bashkisë të cilat paraqiten në relacionin shoqëruar janë: a) Përmirësimi i aksesit në zonat rurale me qëllim zbutjen e pabarazive dhe ofrimin e shërbimeve administrative në të gjithë territorin e Bashkisë b) Menaxhimi sa më të mirë i mbetjeve. Bashkia Shkodër do të promovojë riciklimin e mbetjeve urbane dhe ndarjen e mbetjeve që në burim, duke krijuar kosha të diferencuar c) Zhvillimi ekonomik me theks në mjedis mjedisit në mënyrë që të garantohet mbrojtja e ekosistemeve dhe vlerave të shumta natyrore të Shkodrës. Boshtet kryesore të zhvillimit ekonomik do të jenë zhvillimi rural (bujqësia dhe blegtoaria), turizmi, industria e lehtë/përpunimi, shërbimet, dhe ekonomia e të ardhmes e bazuar në sistemet e teknologjisë së informacionit, ekonomia blu dhe ajo e gjelbër.

## **II. Lista e Programeve të Bashkisë**

Bashkia Shkodër e ka planifikuar ushtrimin e veprimtarisë për periudhën 2024-2026 të ndarë në 20 programe, konkretisht:

- 1. Planifikim, Menaxhim dhe Administrim*
- 2. Shërbimet e policisë vendore*
- 3. Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile*
- 4. Mbështetje për zhvillimin ekonomik*
- 5. Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve*
- 6. Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit*
- 7. Administrimi i pyjeve dhe kullotave*
- 8. Rrjeti rrugor rural*
- 9. Transporti Publik*
- 10. Menaxhimi i mbetjeve*
- 11. Planifikimi urban vendor*
- 12. Shërbimet publike vendore*
- 13. Furnizimi me ujë dhe kanalizime*
- 14. Shërbimet e kujdesit parësor*
- 15. Sport dhe argëtim*
- 16. Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore*
- 17. Arsimit bazë përfshirë parashkollorin*
- 18. Arsimit mesëm i përgjithshëm*
- 19. Përkujdesi social*
- 20. Strehimi social*



### III. Komete për plotësimin e dokumentit të PBA-së 2024-2026

- Programi buxhetor afatmesëm për periudhën 2024-2026 është përgatitur nga Bashkia Shkodër bazuar në Instrumentin e Planifikimit Financiar (FPT); Tabelat janë plotësuar në mënyrën e duhur duke paraqitur një informacion të saktë, me të gjithë informacionin e nevojshëm i cili mund të ndihmojë në analizën e projektbuxhetit afatmesëm.
- Programi Buxhetor Afatmesëm është hartuar në përputhje me formatin e ri të Instrumentit të Planifikimit Financiar duke përfshirë në të dhe listën e produkteve standarte sipas shtojcës nr.4 të udhëzimit.
- Raportet e përcjella në Ministrinë e Financave nga Bashkia Shkodër janë në përputhje të plotë me përcaktimet e udhëzimit dhe paraqesin informacionin e nevojshëm financiar për të kuptuar planin buxhetor afatmesëm 2024-2026;
- Bashkia Shkodër i ka paraqitur të gjitha formatet e kërkuara për PBA 2024-2026. Formatet janë plotësuar përgjithësisht saktë duke reflektuar kërkesat e procedurave për hartimin e programit buxhetor afatmesëm.

### IV. Analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore për periudhën afatmesme

#### Të ardhurat

Bashkia Shkodër ka paraqitur një informacion të detajuar, në analizën për të ardhurat nga burimet e veta sipas taksave dhe tarifave vendore. Referuar tabelës së “Burimeve Buxhetore”, konstatohet se bashkia Shkodër siguron të ardhura nga të ardhurat e veta (taksat dhe tarifat vendore) transferta e pakushtëzuar, ajo e kushtëzuar, transferta e pakushtëzuar sektoriale, si burime kryesore për kryerjen e funksioneve që ushtron. Raporti për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme është hartuar bazuar në politikat fiskale ekzistuese, në ecurinë e realizimit të të ardhurave në vitet e mëparshme, vlerësimet mbi zhvillimet e mundshme ekonomike.

Për vitet 2024-2026 të ardhurat nga burimet e veta janë parashikuar me një ulje rreth 2% në vitin 2024 në krahasim me vitin 2023, dhe për vitet 2025-2026 me ulje në masën rreth 1 %.

Taksat/tarifa që zënë peshën më të lartë ndaj totalit të të ardhurave të veta janë: Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtime të reja, taksa vendore e qarkullimit të mjeteve të përdorura, tarifa e menaxhimit të mbetjeve. Në relacion bashkia ka paraqitur edhe disa politika incentivuese, pjesë e paketës fiskale në taksa (Ulje e taksës së ndërtesës për qëllime banimi në Nj.A. në 30% nga referenca ligjore; Ulje në nivelin maksimal të lejuar prej 30% të taksës së tokës bujqësore; Taksë banese zero për pensionistët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike) dhe ulje në nivelet e kostos së shërbimit të llogarit (Tarifa zero për shërbimin e gjelbërimit për zonat rurale; Tarifa zero për familjet me ndihmë ekonomike; Tarifa të reduktuara 50% sipas kriterëve për pensionistë, invalidë)

Referuar parashikimit të të ardhurave të paraqitur nga bashkia Shkodër konstatohet një nivel në ulje së të ardhurave nga taksat dhe tarifat për periudhën 2024-2026, krahasuar me vitet e mëparshme. Përsa kohë niveli i burimeve të financimit për bashkinë Shkodër për periudhën afatmesme nga të ardhurat e veta është parashikuar me ulje krahasuar me vitin 2023, duhet që bashkia të rishikojë


paketën fiskale dhe mundësinë e rritjes së të ardhurave të veta në vitet në vijim. Sipas informacionit të paraqitur në relacionin shoqëruar në argumentat e paraqitura nga bashkia Shkodër, politika fiskale është shoqëruar me lehtësira fiskale për disa kategori dhe si rrjedhojë disa prej taksave kryesore paraqiten me ulje krahasuar me vitet e mëparshme.

Pesha që zënë të ardhura nga buxheti qendror ndaj totalit të të ardhurave për bashkinë Shkodër për periudhën afatmesme është në nivelin rreth 60 për qind (pa përfshirë transfertat e kushtëzuara). Bashkia Shkodër në periudhën afatmesme duhet të analizojë mundësitë për rritjen e nivelit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, nisur edhe nga fakti se krahasuar me PBA 2023-2025, pesha që zënë transferat nga buxheti qendror në buxhetin e bashkisë është rritur, si rrjedhojë konstatohet se bashkia në funksionimin e saj një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve nuk e financon me burimet e veta.

### Shpenzimet

Shpenzimet totale për bashkinë Shkodër për vitet e PBA-së janë parashikuar 3,337 milion lekë për vitin 2024, për vitin 2025 në vlerën 3,390 milion lekë dhe për vitin 2026 në vlerën 3,453 milion lekë. Në grafikun e mëposhtëm paraqiten shpenzimet e bashkisë Shkodër sipas 8 funksioneve, për 20 programet që ka përdorur bashkia në hartimin e PBA-së. Vihet re, nga grafiku i mëposhtëm se funksionet që zënë peshën më të madhe të buxhetit janë: Shërbimet e Përgjithshme Publike, Çështjet Ekonomike, Mbrojtja e Mjedisit, Strehimi dhe Komoditetet e komunitetit dhe Mbrojtja Sociale (bashkia ka përfshirë në PBA edhe fondet e kushtëzuara që transferohen nga Ministria e Shëndetësisë).

Grafik 1: Shpenzimet sipas funksioneve



Referuar tabelës të PBA 2024-2026 të bashkisë Shkodër, konstatohet se krahasuar ndër vite, shpenzimet në total në vitin 2024 janë parashikuar me një ulje 22.6% kundrejt buxhetit fillestar për vitin 2023, në vitin 2025 me një rritje prej 1.6 % ndaj 2024 dhe në vitin 2026 me një rritje prej 1.8% ndaj 2025. Konstatohet se bashkia Shkodër vijon të mbajë të njëjtin trend rritje për shpenzimet në PBA 2024-2026 krahasuar me parashikimin në PBA 2023-2025.



Vihet re se shpenzimet korente për periudhën afatmesme zënë një pjesë të konsiderueshme të totalit të shpenzimeve, me rreth 62.2 për qind ndaj totalit të shpenzimeve, ndërkohë që shpenzimet për investime zënë një peshë shumë të ulët në masën rreth 8.5 për qind ndaj totalit, në ulje krahasuar me programin buxhetor afatmesëm të një viti më parë. Një peshë të konsiderueshme në shpenzimet operative zënë transfertat për familjet dhe individë (fond i kushtëzuar).

Në periudhën afatmesme bashkia Shkodër duhet të synojë që peshën më të madhe të shpenzimeve buxhetore ta zënë shpenzimet për investime, duke ulur nivelin e shpenzimeve operative dhe shpenzimeve për paga dhe sigurime. Në këtë mënyrë do të ketë një rritje të eficiencës së bashkisë duke ofruar një nivel më të lartë investimesh dhe një shërbim më cilësor ndaj qytetarëve.

### **Shpenzimet e personelit**

Shpenzimet e personelit në vitin 2024 parashikohet të zënë rreth 29.5% ndaj totalit të shpenzimeve të parashikuara për këtë vit, ndërkohë që kjo përqindje është pothuajse e njëjtë edhe për vitet 2025 dhe 2026. Konstatohet se rritja e shpenzimeve të personelit nga viti në vit është e qëndrueshme.

### **Shpenzimet Korente**

Shpenzimet operative në vitin 2024 parashikohet të zënë rreth 62.3 % ndaj totalit të shpenzimeve të parashikuara për këtë vit, ndërkohë që edhe në vitet pasuese parashikohen të zënë të njëjtin nivel ndaj totalit të shpenzimeve të parashikuara. Konstatohet se rritja e shpenzimeve operative nga viti në vit është e qëndrueshme, dhe peshën më të madhe të këtyre shpenzimeve e zënë transfertat për familjet dhe individë.

### **Shpenzimet për Investime**

Shpenzimet për Investime në vitin 2024 parashikohen të zënë rreth 8.1 % të totalit të shpenzimeve të bashkisë Shkodër të parashikuara për këtë vit, në vitin 2025 dhe 2026 parashikohet të zënë rreth 8-9 për qind të totalit të shpenzimeve të parashikuara. Konstatohet se shpenzimet për investime paraqiten me ulje krahasuar me vitet 2022 dhe 2023. Rekomandohet që bashkia Shkodër të rishikojë politikën e saj buxhetore duke rritur nivelin e shpenzimeve për investime.

## **V. Shpenzimet e programeve me produkte dhe Pema e programit**

Bashkia Shkodër ka paraqitur në Programin Buxhetor Afatmesëm për të 20 programet informacionin për politikën e çdo programi (qëllimet e politikës së programit, objektivat e programit dhe treguesit përkatës së performancës), për planet e shpenzimeve sipas produkteve të programit, për projektet e investimeve si dhe statistika të përgjithshme sipas programeve.

Me formatin e ri të Instrumentit të Planifikimit financiar janë plotësuar të gjitha programet buxhetore. Duke mbajtur në konsideratë faktin e vështirësive që kanë hasur njësitë vendore për vitin 2023 në plotësimin e formatit të ri të IPF-së dhe planifikimit afatmesëm me tregues performance dhe produkte për çdo program buxhetor vlerësojmë punën e bërë nga bashkia Shkodër për hartimin e PBA-së 2024-2026.

## **Prioritetet buxhetore afatmesme 2024-2026 dhe treguesit kryesorë të performancës për disa programe.**

Për programin **Planifikim, Menaxhim, Administrim** synohet burime një strukturë menaxhuese cilësore, duke krijuar mundësinë dhe lehtësinë për përthithjen e burimeve njerëzore profesionale dhe në funksion të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të bashkisë, si dhe sigurimi i një shërbimi sa më cilësor ndaj komunitetit, nëpërmjet:

- rritjes së qendrueshmërisë së administratës publike
- përmirësimit të punës së stafit të bashkisë (0% masa disiplinore)
- rritjes së konsultimit me publikun
- shtimit të numrit të njësive administrative me akses në internet
- rritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore të bashkisë (raporti i punonjesve të trajnuar kundrejt totalit të punonjësve të bashkisë).

Për programin **Shërbimet e policisë vendore**, synohet garantimi për të gjithë qytetarët shërbime publike cilësore në të gjithë territorin, përmirësimin e eficiencës dhe efektivitetit të shërbimeve publike si dhe modernizimit të tyre nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të teknologjisë, ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike, nëpërmjet:

- kualifikimit të punonjësve të policisë bashkiake
- rritjes së rasteve të menaxhuara nga ana e policisë bashkiake
- uljes së shpenzimeve buxhetore për shërbimet e policisë bashkiake kundrejt totalit të rasteve të menaxhuara
- rritjes së numrit të kamerave të vendosura në pikat strategjike të qytetit

Për programin **Shërbimet publike vendore** synohet: Përmirësimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane, rritja e mbulimit me shërbim, përmirësimi i administrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane, nëpërmjet:

- rritjes së raportit të sipërfaqes së gjelbëruar kundrejt sipërfaqes totale të bashkisë (nga 83% në 86%).
- rritjes së territorit me ndiçim publik, sipërfaqe e shtuar e rrugëve dhe shesheve të ndriçuara (nga 87% në 100%).

## **VI. Projektet prioritare të investimeve në periudhën afatmesme**

Investimet prioritare kryesisht janë të përqendruara në projekte për rikonstrukcion rrugësh, në arsim (rikonstrukcion shkollash), në rehabilitim të hapësirave publike. Konstatohet se pjesa më e madhe e projekteve të investimeve kryesisht paraqiten të përfundojnë në vitin 2026. Ndërkohë, bashkia parashikon investime në nivele shumë të ulëta për periudhën afatmesme. Si rrjedhojë, nxisim bashkinë Shkodër në rritjen e peshës që zënë shpenzimet për investime dhe hartimin e projekteve me ndikim të drejtëpërdrejtë në përmirësimin e jetës së qytetarëve, për periudhën afatmesme.



## **VII. Detyrimet e prapambetura**

Bashkia Shkodër bazuar në formation C2 “Detyrimet e Prapambetura” të Instrumentit të Planifikimit Financiar ka paraqitur informacion mbi detyrimet e prapambetura dhe amortizimin e tyre. Stoku i borxhit i paraqitur është në vlerën 571 mijë lekë, të cilin bashkia Shkodër parashikon ta shlyejë brenda vitit 2023.

## **VIII. Treguesit kryesorë financiarë**

Bashkia Shkodër ka paraqitur në relacionin shoqërues treguesit kryesorë financiarë. Raporti i të ardhurave të veta vendore ndaj të ardhurave të përgjithshme nga 27 % në vitin 2024, parashikohet me ulje në vitet 2025-2026, në 26%. Raporti i shpenzimeve për investime kapitale ndaj shpenzimeve të përgjithshme paraqitet në nivele të ulëta për periudhën afatmesme (8%-9%), krahasuar me vitin 2023, kur ky raport paraqitet në masën 20%. Ndërkohë raporti i shpenzimeve korente ndaj shpenzimeve totale paraqitet në nivele shumë të larta për periudhën afatmesme.

## **IX. Rreziqet financiare dhe fiskale të Bashkisë**

Bashkia Shkodër për realizimin e të ardhurave të veta vendore, njëkohësisht duke ruajtur tendencën për përmirësimin e politikave dhe strategjive incentivuese e zhvilluese të ekonomise lokale, ka hartuar strategjinë për menaxhimin e riskut. Gjithashtu, bashkia ka paraqitur në relacionin shoqërues edhe regjistrin e riskut duke argumentuar edhe çfarë është bërë në drejtim të përmirësimit të secilit prej risqeve të identifikuar.

## **X. Rekomandime**

Roli kryesor i PBA-së është të sigurojë që politika, objektivat dhe qëllimet të jenë të përcaktuara qartë si dhe programet/produktet e synuara do të arrijnë objektivat dhe qëllimet e politikës në një mënyrë që krijon një përdorim ekonomik, eficient dhe efektiv të fondeve buxhetore.

Duke mbajtur në konsideratë faktin e vështirësive që kanë hasur njësitë vendore për vitin 2023 në plotësimin e formatit të ri të IPF-së dhe planifikimit afatmesëm me tregues performance dhe produkte për çdo program buxhetor vlerësojmë punën e bërë nga bashkia Shkodër për hartimin e PBA-së 2024-2026. Buxhetimi mbi bazë produkti dhe kostimi i tyre përbën një punë shumë të mirë të bashkisë Shkodër në drejtim të hartimit të një buxheti në përputhje me standartet ligjore.

Rekomandojmë që në hartimin e treguesve të performancës që do të përdoren për çdo program buxhetor bashkia të mbajë në konsideratë se këta tregues duhet a) të përfaqësojnë politikën kombëtare / standardin kombëtar; b) të jenë të matshëm; c) të ekzistojnë të dhëna historike; ose mund të ndërtohen baza të dhënash lehtësisht; d) të japin sa më mirë performancën e shërbimit që prodhon programi; f) të jenë të thjeshtë; pra të mund të raportohet tek Këshilli bashkiak dhe komuniteti;

Rekomandojmë që në periudhën afatmesme shpenzimet operative të jenë të qëndrueshme dhe në rënie të vazhdueshme në funksion të rritjes së investimeve, si dhe të të synohet ulja e nivelit të shpenzimeve të personelit në mënyrë që të rritet efienca e ofrimit të shërbimeve.



Bashkia Shkodër në periudhën afatmesme duhet të analizojë mundësitë për rritjen e nivelit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore. Pesha që zënë transferat nga buxheti qendror në buxhetin e bashkisë është rritur, si rrjedhojë konstatohet se bashkia në funksionimin e saj një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve nuk e financon me burimet e veta.

Konstatohet se shpenzimet për investime në PBA 2024-2026 paraqiten me ulje krahasuar me vitet 2022 dhe 2023. Rekomandohet, që bashkia Shkodër të rishikojë politikën e saj buxhetore duke rritur nivelin e shpenzimeve për investime.